



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.953/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm– Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit S.T nga ... me vendbanim rruga “...”, për shkak te veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-es, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovicë PP.II.nr.4197/2018 te datës 12.11.2018, ne mungese të PTH Jelena Marjanoviq, ne prezence te te pandehurit me dt. 27.12.2018 ka shpallur publikisht, ndërsa me 10.01.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: S.T, nga i ati D., e ema S., e gjinisë C., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne ..., rruga “...” , shqiptar, kosovar , me profesion bukëpjekës, i martuar, baba i shtate fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Nga data e pa vërtetuar deri me dt. 13.12.2017 ne ... ne rrugën “...” me qellim te përfitimit te dobisë pasurore për vete ne mënyrë te paligjshme shfrytëzoi energjinë elektrike pa autorizimin e KEDS-it, ashtu që konsumatori drejtpërdrejt u kyç ne kabull dhe rrjetin elektrik jashtë matësit dhe ter objektin furnizoi pa matje. Pra duke mos pasur autorizimin nga furnizuesi, pa autorizim shfrytëzoi energjinë elektrike dhe me këtë përfitoi debi ne shume prej 2.717.45duke dëmtuar Korporatën e Kosovës për shpërndarje dhe furnizim me energji elektrike për shumen ne fjale.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës.

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,46,49,51,52,73, dhe 320 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450 dhe 463 te KPP-ës i:

G J Y K O N

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe me dënim me gjobe ne shume prej 400 (katërqind euro), i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vite.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30 Euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike –kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP-II.nr.4197/2018 te datës 12.11.2018 kundër te pandehurit S.T, për shkak te veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.26.12.2018 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe nuk do te përsëris më vepra te tilla apo vepër tjetër penale.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja i ka propozuar gjykatës që të pranohet fajësia e te pandehurit nga se pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat mbështetësin rrethanat faktike te çështjes se aktakuzës, te këtë parasysh rrethanat e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit, nga se i njëjti është baba i shtat fëmijëve dhe i propozon gjykatës qe te merr si rrethane lehtësuese me rastin e shqiptimit te dënimit.

Lidhur me pranimin e fajësisë mbrojtësi Av. V.M deklaron se i mbrojturi im pa kurrfarë presioni kërcënimi, shtrëngimi, apo lajthimi, vendosi qe ta pranoj fajësinë lidhur me veprën penale qe i vihet ne barre, gjykatës i propozon qe te këtë parasysh këto rrethana lehtësuese, se i njëjti është i moshës se shtyrë ne pension, është i një familje 14 anëtarësh i njëjti ka pas veshtersi familjare. Gjykatës i propozon qe te këtë parasysh disa rrethana lehtësuese me rastin e shqiptimit te dënimit dhe ti shqiptoj një dënim me te butë.

II. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Vështrimi ne procesverbalin nr. ... me dt.13.12.2017 si dhe Faktuara me nr. ... me dt.15.12.2017, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: vjedhja e shërbimeve komunale nga neni320 te KPRK-së.

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me dënim me gjobë dhe me burgim deri ne 3 vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjesisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale, ne rastin konkret i pandehuri kishte përvetësuar dobi pasurore për veten.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, i njëjti është baba i shtat fëmijëve është i moshës se shtyrë është ne pension, është mbajtës i familjes, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë rezulton se i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se ne te dhënat e shkresave te lendes nuk rezulton se ky i pandehur te jete dënuar ndonjë here për ndonjë veprë penale apo te zhvillohet ndonjë procedurë penale, prandaj gjykata vlerëson se bazuar ne këto rrethana ky i pandehur kishte rënë ndesh me ligjin vetëm me rastin konkret ku e ka pranuar fajësinë.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit, do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që te pandehurin ta detyroj qe shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30 € (tridhete euro), te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, e 463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.953/2018 dt.10.01.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.